UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 4695/4, datë 2.11.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 4695, DATË 31.5.2016, "PËR PROCEDURAT E HOLLËSISHME TË REGJISTRIMIT DHE LËSHIMIT TË CERTIFIKATËS SË PASURISË SË PALUAJTSHME TË LEGALIZUAR"

Në mbështetje të neneve 17 dhe 49, të ligjit nr. 33/2012, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", neneve 4, 29 dhe 30, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, si dhe në zbatim të pikës 13, të VKM-së nr. 1095, datë 28.12.2015, "Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës, ndërmjet ALUIZNI-t dhe ZQRPP-së, dhe të procedurave apo kufizimeve që zbatohen për efekt të regjistrimit të pasurive të legalizuara", kryeregjistruesi dhe drejtori i përgjithshëm i ALUIZNI-t,

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 4695, datë 31.5.2016, "Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar", bëhen këto ndryshime:

1. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

"12. Regjistruesi vijon me regjistrimin e lejes së legalizimit për ndërtimin e ngritur mbi truallin e një objekti që rezulton i shembur, mjafton që subjekti të depozitojë pranë ALUIZNI-t deklaratën noteriale të prishjes së objektit. Ky dokumentacion përcillet pranë ZVRPP-së së bashku me atë të përcaktuar në pikën 10, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 28.12.2015".

2. Në pikën 26, germa "b", riformulohet si më poshtë:

"b) Kur marrëdhënia e pronësisë me truallin nuk është rregulluar ende, ZVRPP-ja zbaton rregullin e përcaktuar në pikën 13 të këtij udhëzimi dhe detyrohet të kryejë regjistrimin e pronësisë mbi parcelën ndërtimore, menjëherë pas miratimit të VKM-së "Për kompensimin e pronarëve".

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEREGJISTRUESI
Ilirjan Muho

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Artan Lame